

17105

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 7104 i aktit

V E N D I M

PER RREGJISTRIMIN SI PERSON JURDIK

Ne Tirane, sot me date 4/3/07, une Gjygtarja e Gjykates se rrethit Tirane M. Dedi, pasi shqyrtova materialin e paraqitur nga zoti Xhevdet Shehu shtetas shqiptar madhor ,dhe i afte per te kryer veprime juridike, per rregjistrimin si person juridik te Shoqerise "ELBA-SHEHU" sh.p.k. Elbasan, me kapital 100.000 leke, me seli ne qytetin e Elbasanit, lagja "11-Nentori", Fax-tel. 21-27.

K O N S T A T O V A

Se kerkuesi kerkon te rregjistroje si person juridik shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "ELBA-SHEHU" SH.P.K. me ortake zoterinjte Xhevdet Shehu, Ylli Shehu dhe Edmond Shehu, me seli ne qytetin e Elbasanit, lagja "11-Nentori", Fax-tel. 21-27, me kohezgjatje deri ne vitin 2006, me kapital 100.000 leke dhe me objekt veprimtarie ne fushen e :

- Eksport import te bimeve medicinale, dhe te gjitha llojeve te mallrave industriale, konfeksione, ushqimore, pjese kembimi, paisje e makineri.
- Shitje me shumice e pakice.

Kerkesa e tij eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638, date 19.11.1992 dhe ligjit 7667, date 28.01.1993. per rregjistrin tregtar e formalitetet qe duhen plotesuar ne te:

V E N D O S A

Rregjistrimin si person Juridik te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ELBA-SHEHU" sh.p.k. - Elbasan, me ortake zoterinjte Xhevdet Shehu, Ylli Shehu dhe Edmond Shehu dhe per te ushtruar veprimtari tregtare ne fushen e:

- Eksport import te bimeve medicinale, dhe te gjitha llojeve te mallrave industriale, konfeksione, ushqimore, pjese kembimi, paisje e makineri.
- Shitje me shumice e pakice.

si Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me ortake zoterinjte Xhevdet Shehu, dhe Ylli Shehu dhe Edmond Shehu me kapital 100.000 leke, me kohezgjatje deri me 31.12.2006, me administrator zotin Xhevdet Shehu me seli ne qytetin e Elbasanit, lagja "11-Nentori", Fax-tel. 21-27.

Kunder ketij Vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit.

GJYQTARE
MARJANA DEDI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR AKTIT 1104/2

V E N D I M
I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 26/04 2002, une Gjyqtaria e Gjykates se shkalles se pare -Tirane R. Paqer pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga z.Xhevdet Shehu, Z.Ylli Shehu dhe Z. Edmond Shehu ortake te shoqerise "ELBA-SHEHU" sh.p.k. te cilet me kerkuan depozitim ne rregjistrin tregtar te : -Vendimit te Asamblese se Ortakeve te kesaj Shoqerie me Nr-1 date 16-04-2002 mbi shitblerjen e kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise dhe depozitim e kontrates se shitblerjes se kuotave me nr rep 769, kol. 179, date 16-04-2002, notere Anila Batalli .

K O N S T A T O V A

Se shoqeria "ELBA-SHEHU" sh.p.k eshte e rregjistruar si Person Juridik ne Gjykatën e Tiranës me vendimin nr 17104 date 04-05-1997 .Sipas ketij vendimi shoqeria rezulton te kete ortake te saj Z. Xhevdet Shehu, Ylli Shehu, Edmond Shehu , administrator Z. Xhevdet Shehu, kapital fillestar te shoqerise 100.000 leke dhe objekt te aktivitetit te saj ne fushen e : "Eksport-import te bimeve medicinale, te te gjitha llojeve te mallrave industriale konfeksione, ushqimore, pjese kembimi, pajisje e makineri, shitje me shumice dhe me pakice ."

Me vendimin nr 1 date 16-04-2002 te asamblese se ortakeve te Shoqerise "ELBA-SHEHU" sh.p.k.eshte vendosur transferimi i kuotave te kapitalit themeltar -nga ortakut Edmond Shehu ne favor te Z. Xhevdet Shehu dhe Z. Ylli Shehu .

Me kontraten e shitblerjes nr rep 769 nr kol 179 date 16-04-2002 notere Anila Batalli . u procedua me transferimin e kuotave te kapitalit themeltar nga ortakut Edmond Shehu ne favor te ortakeve Xhevdet Shehu e Ylli Shehu .

Duke iu referuar akteve te mesiperme shoqeria "ELBA-SHEHU" sh.p.k. ka ortake te saj Z. XHEVDET SHEHU me pjesemarrje 50 % te kuotave te kapitalit fillestar te shoqerise dhe Z. YLLI SHEHU me pjesemarrje 50 % te kuotave te kapitalit fillestar te shoqerise.

Kerkesa eshte e drejte dhe duhet pranuar.

P E R K E T O A R S Y E

Ne baze te ligjit Nr.7638 date 19-11-1992 dhe ligji 7667 date 28.01.1993

V E N D O S A

-Pranimin e kerkeses dhe te dokumentacionit te paraqitur nga ortakët e shoqerise "ELBA-SHEHU" sh.p.k .

Depozitim e Vendimit nr 1 date 16.04.2002 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "ELBA-SHEHU" sh.p.k. dhe kontraten e shitblerjes se kuotave date 16.04.2002 nr rep 769 nr kol 179 notere Anila Batalli , duke bere shenimet perkatese ne kolone Nr 4 , germa _____ kolonen 5 dhe _____ te rregjistrin tregtar .

Gjyqtari
R. Paqer
2002

REPUBLIKA SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 17104 / Zvendimit

V E N D I M

I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 1/1/2009 une gjyqtar i Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, pasi shqyrtova kerkesen e kerkuesve: z.Xhevdet Shehu i biri Bajramit dhe Myneverit, lindur me 28.01.1956 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan dhe z. Ylli Shehu i biri Bajramit dhe Myneverit, lindur me 26.03.1958 ne Elbasan dhe banues ne Elbasan, te cilet kerkuan depozitimn e Vendimit te Asamblese se Ortakeve nr.2 date 01.09.2004 te shoqerise "ELBA-SHEHU" sh.p.k.

K O N S T A T O V A:

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ELBA-SHEHU" sh.p.k eshte e rregjistruar si person juridik ne baze te vendimit me nr.17104 date 04.05.1997. Ne baze te ketij vendimi shoqeria "ELBA-SHEHU" sh.p.k eshte e rregjistruar ne rregjistrin tregtar te shoqerive me tre ortake: Xhevdet Shehu, Edmond Shehu dhe Ylli Shehu dhe me administrator ortakun e saj z.Xhevdet Shehu, me seli ne Elbasan, lagjia "11 Nentori" me kapital themeltar 100.000(njeqindmije) leke.

Me vendimin e Gjyqtarit te Vetem nr.akti 17104/1 date 24.04.2002 eshte vendosur transferimi i kuotave te ortakut Edmond Shehu dhe shoqeria "ELBA-SHEHU" behet me dy ortake Xhevdet Shehu dhe Edmond Shehu duke zoteruar secili nga 50% te kapitalit dhe me administratore ortaket e shoqerise z. Xhevdet Shehu dhe z.Ylli Shehu.

Me vendimin e Asamblese se Ortakeve nr.2 date 01.09.2004 eshte vendosur:

1. Te shtoje objektin e veprimtarise se shoqerise ne nenin nr.5 te statutit te shoqerise si vijon:

^ "Kultivimin e bimeve te rralla, bimeve mjekesore, aromatike, eterovajore dhe ushqimore".

2. Ky vendim i bashkengjitet Statutit te shoqerise "ELBA-SHEHU" sh.p.k.

3. Ky vendim te depozitohet ne rregjistrin tregtar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.

Ne keto kushte kerkuesit kerkojne depozitimn e vendimit prane rregjistrin tregtar.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE:

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667 date 28.1.1993 "Per rregjistrin tregtar"

V E N D O S A:

Pranimin e kerkeses.

Depozitimn ne rregjistrin tregtar te vendimit te Asamblese se Ortakeve nr.2 date 01.09.2004 te shoqerise "ELBA-SHEHU" sh.p.k.-----

Te behen shenimet perkatese ne Rregjistrin Tregtar

GJYQTAR

Armando Paj

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR. 17104/3 Akti

VENDIM
I GJYOTARIT TE VETEM

Ne Tirane , sot me date 10. 04 .2006 une gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane

Beuri lola Zaoni pasi mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi Administrator i Shoqerise ELBA SHEHU Sh.p.k, i cili kerkon depozitimn e Vendimit Nr.3 date 20.01.2006 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise ELBA SHEHU Sh.p.k.

KONSTATOVA

Me vendimin e Gjykates Nr. 17104, date 04.05.1997, eshte bere rregjistrimi i Shoqerise ELBA SHEHU Sh.p.k me administrator Z. Xhevdet Shehu dhe me tre ortake Xhevdet Shehu , Ylli Shehu dhe Edmond Shehu me seli ne Elbasan, Lagja 11 Nentori, me kapital themeltar 100.000 (njqind mije) leke.

Me vendimin e gjyqtarit te vetem Nr.17104/1 Akti date 24.04.2002 eshte vendosur transferimi i kuotave te ortakut Edmond Shehu dhe Shoqeria ELBA SHEHU behet me dy ortake Xhevdet Shehu dhe Ylli Shehu.

Me vendimin e gjykates Nr.17104/2 date 09.09.2004 eshte vendosur shtimi i objektit te veprimtarise ne:

“Kultivimi i bimeve te rralla, bimeve mjekesore,aromatike,eterovajore dhe ushqimore”

Me vendimin Nr.3 date 20.01.2006 te Asamblese se ortakeve dhe sipas kontrates se shitjes se kuotave hartuar ne noterine Elbasan eshte vendosur:

- 1.Ylli Shehu dhe Xhevdet Shehu te shesin nje pjese te aksioneve te tyre ortakut te ri Edmond Shehut
- 2.Te pranoje si ortak te ri ne kuoten ne masen 33,33% Edmond Shehun
- 3.Ylli Shehu dhe Xhevdet Shehu mbesin ortake me pjesemarje ne kuota ne masen 33,33 % secili

4. Te miratohen ndryshimet ne statut dhe ne akt themelimin persa i perket ortakeve dhe kuotave pjesemarese

Ne keto kushte kerkuesi kerkon depozitimin e vendimit prane rregjistrin tregtar

Kerkesa eshte e drejte dhe ne baze te ligjit duhet pranuar

PER KETO ARSYE

Ne mbeshtetje te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" dhe atij Nr.7667 date 28.01. 1993 "Per Rregjistrin Tregtar"

VENDOSA

-Pranimin e kerkeses

-Depozitimin e vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "ELBA SHEHU" Sh.p.k Nr.3 date 20.01.2006 si dhe kontraten noteriale te shitjes se kuotave Nr.41 Kol , Nr.172 Rep date 20.01.2006

-Urdherohet Zyra e Rregjistrin Tregtar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise

GJYQTARE

Beunis lola Krasni
Samir D. 2006

V E N D I M
I
GJYQATARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 20/10/2006, une gjygtari I Gjykates se Rrethit Gjygesor Tirane [Signature], mora ne shqyrtim kerkesen dhe dokumentacionin e paraqitur nga kerkuesi z. Xhevdet Shehu , me cilesine e Ortakut te vetem dhe administratorit te Shoqerise "ELBA SHEHU "SH.P.K., persa I perket ndryshimit te Statutit te kesaj Shoqerie te rregjisitruar si person juridik prane kesaj Gjykate.

K O N S T A T O V A

Me vendimin nr. 17104 dt 4.5.1997, te gjykates se rrethit Tirane eshte bere regjistrimi I personit juridik "ELBA SHEHU " SH.P.K. me objekt veprimtarie ne:

-eksport import te bimeve medicinale, te te gjitha llojeve te mallrave, konseksione, ushqimore, pjese kembimi, paisje , makineri, shitja me shumice e pakice,

Me vendimin numer 17104/ 1 dt 24.4.2002, eshte bere crregjistrimi i ortakut Edmond Shehui, dhe mbetja ne shoqeri te ortakeve Ylli Shehu dhe Xhevdet shehu me 50% te kuotave sejcili .

Me vendimin nr 17104/2 dt 9.9.2004, eshte bere shtimi i objektit te veprimtarrise se shoqerise ne ' Kultivimin e bimeve te rrala mjeksore, aromatike, eterovajore dhe ushqimore '

Me vendimin numer 17104/3 dt 10.04.2006, eshte bere pranimi i Edmond shehu si ortak ne shoqeri, me pjesmarrje ne kuota ne masen 33.33% sejcili .

Me vendimin e asamblese se Ortakeve ne mbledhjen e dates9.2006, eshte vendosur shtimi I objektit te veprimtarisee duke I shtuar nenit 4 te statutit, nenin 4/1 me objekt :

- **Studime e projektme te punimeve pyjore** (hartimi i planeve temenaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjuetise sportive e turistike te kullotave, hartimin e projekteve te pyllzimit, hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve , hartimin e projekteve te shfrytezimit te qendrushem te pyjeve, hartimin e projekteve te menaxhimit te pellgjeve ujembledhes, studime fitopatologjike - entomologjike dhe zjarreve ne pyje, studimin e menaxhimit e perdorimit te territorit, studimin e rezervave gjenetike dhe biodiversitetin).

- **Zbatime te punimeve pyjore** (permiresimin e pyjeve, ricungime trajtim pyjesh prerje kulturore , per pyllzime, fidanishte grumbullime, trajtime farash pyjore, punime pergatitore, mbjellje fidanesh, per shfrytezimin e qendrushem te pyjeve , sistemime malore, ndertime te rrugeve pyjore, grumbullimin dhe vjeljen e qendrushme te prodhimeve pyjore jo drusore dhe te flores spontane mjeksore dhe tanifere, ushtrimin e gjuetise sportive e turistike te faunes se eger, mbrojtejn nga semundjet demtuesit dhe zjarret, punime ne kullota livadhedhe , ndertimin e meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota dhe livadhe).

Kerkesa eshte e drejte dhe ne baze te ligjit duhet pranuar.

PER KETO ARSYE.

Ne baze te ligjit nr.7667 dt. 28.01.1993"Per regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqeria Tregtare" dhe te ligjit 7638 dt. 19.11.1992"Per Shoqerite Tregtare",

V E N D O S A :

- Pranimin e Kerkeses
- Depozitimn e vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise "ELBA SHEHU " SH.P.K., Nr 4, date9.2006, per shtimin e objektit te veprimtarise ne :

- **Studime e projektme te punimeve pyjore** (hartimi i planeve temenaxhimit te pyjeve, flores spontane, gjuetise sportive e turistike te kullotave, hartimin e projekteve te pyllzimit, hartimin e projekteve te trajtimit te pyjeve , hartimin e projekteve te shfrytezimit te qendrushem te pyjeve, hartimin e projekteve te menaxhimit te pellgjeve ujembledhes, studime fitopatologjike –entomologjike dhe zjarreve ne pyje, studimin e menaxhimit e perdorimit te territorit, studimin e rezervave gjenetike dhe biodiversitetin).

- **Zbatime te punimeve pyjore** (permiresimin e pyjeve, ricungime trajtim pyjesh prerje kulturore , per pyllzime, fidanishte grumbullime, trajtime farash pyjore, punime pergatitore, mbjellje fidanesh, per shfrytezimin e qendrueshem te pyjeve , sistemime malore, ndertime te rugeve pyjore, grumbullimin dhe vjeljen e qendrueshme te prodhimeve pyjore jo drusore dhe te flores spontane mjeksore dhe tanifere, ushtrimin e gjuetise sportive e turistike te faunes se eger, mbrojtejn nga semundjet demtuesit dhe zjarret, punime ne kullota livadhedhe , ndertimin e meremetimin e veprave per sigurimin e ujit te pijshem ne kullota dhe livadhe).

-Te behen ndryshimet perkatese ne zyren e regjistrin tregtar.

GJYQ TAR,

Blendi Keçiçi
[Signature]

Unaltes registriumi

1- 19104

2- a- "Eiba- Slehur" rlyph

b- Elbasan 1711 Neutori,

c- uip-eksp, leimë me-
dicinale, malne inat,
ushp, pj. heubiumi, pajsije
e malimeri, Sliqje me
E e panicef.

2- 100000 lekë

1- Xhurolet Slehur 34%

2- Ylli Slehur 33%

3- Edmond Slehur 33%

3- Xhurolet Slehur, i biri

i Bajramit, dt 1956, lindur
e be mes Elbasan.

4- deri 40 vitet 2006.

st 3 flete + 11%

k. 2/13 flete + 11%

5- 28.2.97

4.03.97

Gjyqtare

(Merjona Joli)
[Signature]

M. Arditiumi - 023786 Nr llog. 1231/7121

dt 26.2.97

BKT Elbasan.



AKT-THEMILIMI

i

SHOQERISE TREGTARE "ELBA-SHEHU" SH.P.K.

Ne baze te nenit 2 te ligjit nr.7512, date 10.08.1991, "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private te nismes se lire, te veprimtarive private te pavaruar te privatizimit" dhe zbatim me ligjin nr.7638, date 19.10.1992, "Per shoqerite tregtare" behet themelimi i shoqerise "ELBA-SHEHU" ,me seli ne qytetin e Elbasanit, lagja "11-Nentori", Fax-tel. 21-27, e mbeshtetur ne statutin e kesaj shoqerie me ortake zoterinjte Xhevdet Shehu, Ylli Shehu, dhe Edmond Shehu shtetas shqiptar.

VENDOS :

Te krijoje nje Shoqeri Tregtare te emertuar "ELBA-SHEHU" SH.P.K. kushtet e meposhtme:

NENI 1

Themeluesit ne cilesine e ortakeve krijojne shoqerine tregtare "ELBA-SHEHU", SH.P.K. me statusin juridik te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.7638, date 19.11.1992, (Per shoqerite tregtare), me mjetet e veta financiare dhe duke paguar kontributin ne para.

NENI 2

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjilacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statusin e bashkelidhur.

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin "ELBA-SHEHU" SH.P.K., emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj... Ajo ka vulen e saj, ne te cilen eshte shkruar "ELBA-SHEHU" SH.P.K, Elbasan- Albania.

NENI 4

Shoqeria e ka seline e saj ne Elbasan, lagja "11-Nentori", Fax-tel. 21-27. Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte saj.

NENI 5

Afati i veprimtarise se Shoqerise caktohet 10 vjet, me perjashtim te rastit kur ortaket i vendosin nje prishje te parakoshme te saj ose vendosin per shtytje te metejshme.

NENI 6

Objekti i veprimtarise do te jete :

- Eksport import te bimeve medicinale, dhe te gjitha llojeve te mallrave industriale, konfeksione, ushqimore, pjese kembimi, paisje e makineri.
- Shitje me shumice e pakice.

NENI 7

Me vendimin e themeluesve te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas blerjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kte akt themelimi.



NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqson kontributet ne para dhe eshte 100000 leke. Ky kapital ndahet ne 100 kuota te barabarta me nga 1000 leke secila.

Ortaku Xhevdet Shehu zoteron 34% te kapitalit.

Ortaku Ylli Shehu zoteron 33% te kapitalit.

Ortaku Edmond Shehu zoteron 33% te kapitalit.

NENI 9

Shoqeri kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte pergjegjes per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

NENI 10

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkalidhur.

Shoqeria do te drejtohet nga nje keshill administrativ. Themeluesit, me vendim te vecante do te emerojne dhe nje eksperte kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin", si dhe do te krijoje fondin rezerve. Fitimi neto qe do te rezultojte ne fund te cdo viti financiar ne baze te nenin 214 te ligjit nr.7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare" pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjet e mbajtura nga vitet e meparshme do ti kaloje ortakeve.

NENI 11

Percaktimi i struktures organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emertimet e shkarkimet ne organet e saj, behen nga keshilli administrativ.

Mardheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

NENI 12

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

**THEMELUESIT
E SHOQERISE -ELBA-SHEHU"-SH.P.K.**

XHEVDET SHEHU

YLLI SHEHU

EDMOND SHEHU



STATUT

i Shoqerise Tregtare "ELBA-SHEHU" SH.P.K.

Shoqeria tregtare "ELBA-SHEHU" SH.P.K. krijohet ne perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992, per shoqerite tregtare.

Kreu I

Dispozita te pergjithshme

NENI 1

Shoqeria "ELBA-SHEHU" SH.P.K. eshte person juridik shqiptar. Ajo gezon personalitetin juridik qe nga momenti i regjistrimit ne Regjistrin Tregtar dhe ne zyren e Tatimeve. Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e themelimit (Akti i themelimit dhe Statuti).

NENI 2

Shoqeria "ELBA-SHEHU" SH.P.K. eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me seli ne Elbasan, lagja "11-Nentori", Fax-tel-2127. Ajo mund te çele zyra perfaqesie, dege ose filiale ne qytete te tjera te shqiperise ose jashte saj.

NENI 3

Shoqeria "ELBA-SHEHU" parashikohet te zhvilloje veprimtarine e saj per nje kohe prej 10 vjetesh, me perjashtim te rastit kur ortaket vendosin prishjen e saj para ketij afati ose kur vendos shtyrjen e veprimtarise se saj tej afatit te mesiperm.

NENI 4

Emertimi i shoqerise eshte "ELBA-SHEHU". Ky emrtim vendoset ne gjithe letrat qe perdoren per korespondence ne faturat, ne te gjitha reklamat dhe botimet e nxjerra prej saj dhe do te pasohet nga fjala "SH.P.K." ose "Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" nga numri i regjistrimit te saj dhe selia.

KREU II

Objekti i veprimtarise

NENI 5

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

-Eksport import te bimeve medicinale, dhe te gjitha llojeve te mallrave industriale, konfeksione, ushqimore, pjese kembimi, paisje e makineri.

-Shitje me shumice e pakice.

NENI 6

Ortaket rezervojne te drejten te modifikojne objektin e veprimtarise ne çdo kohe.

KREU III

Kapitali Themeltar

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontribute ne para te nenshkruara e te shlyera nga ortaket. Kapitali themeltar eshte 100000 leke i ndare ne 100 pjese te barabarta me nga 1000 leke secila.

Ortaku Xhevdet Shehu zoteron 34% te kapitalit.

Ortaku Ylli Shehu zoteron 33% te kapitalit.

Ortaku Edmond Shehu zoteron 33% te kapitalit.



KREU IV Organet e Shoqerise

NENI 8

Ortaket ushtrojne kompetencat qe i jane caktuar Asamblese se ortakeve, ne baze te ligjit Nr.7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare". Ata merrin vendime per veprimtarine e shoqerise dhe politiken ekonomike e tregtare te saj.

NENI 9

Vendimet ne emer te ortakeve nenshkruhen sipas parashikimeve te percaktuara ne stautin dhe aktin e themelimit te shoqerise. Ortaket marrin vendime per ceshtjet e meposhtme:

- Miratojne strukturen organizateve te shoqerise dhe numrin e vendeve te punes ne te.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e shoqerise. Administratori i shoqerise caktohet zoti Xhevdet Shehu.
- Ndryshon e modifikon statutin e shoqerise dhe kapitalin themeltar e objektin e veprimtarise se shoqerise, si dhe per ndryshimin e formes juridike te shoqerise.
- Miraton llogarite pas raportit te eksperteve kontabel.
- Emeron prishjen e shoqerise para afatit te percaktuar ne aktin e Themelimit ose per kalimin e ketij afati.
- Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar.
- Riorganizimin, mbarimin dhe prishjen e shoqerise dhe likujdimin e saj.
- Orjentimet baze te cilave do te drejtoje veprimet shoqeria, e do te caktojte preferencat e politikës se saj ekonomike e komerciale. Ndermarrjen e aktiviteteve te reja afariste.
- Dhenien ne peng, hipoteke apo siguri tjeter te ngjashme.

NENI 10

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise si dhe ato te percaktuara ne nenin 50 te ligjit nr. 7638, date 19.11.1992

" Per shoqerite tregtare". Ai ka te drejta te plota per drejtimin operativ te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha veprimet qe duhen per aktivitetin e shoqerise me perjashtim te atyre qe jane parashikuar ne nenin 9 te ketij statuti qe i perkasin ortakeve.

Administratori perfaqson shoqerine ne te gjitha veprimet juridike e financiare te saj me pale te tjera, me banka, shoqeri transporti etj. E drejta e firmes per veprimet e kryera nga shoqeria dhe qe ndodhen brenda kompetencave te administratorit sipas ketij neni i takon ketij te fundit.

Ortaket kane te drejte te zevendesojne ne çdo kohe administratorin e emeruar me nje tjeter ose me nje keshill administrativ.

NENI 11

Ortaket emerojne deri ne 2 eksperte kontabel per nje periudhe kohe prej 6 vitesh financiare te cilat ushtrojne kontroll te veprimtarise se shoqerise.

Ekspertet kontabel bejne te gjitha verifikimet e kontrollet qe i gjykojne te nevojshme, ne cdo kohe te vitit dhe te dy bashke ose veç e veç. Ata mund te shqyrtojne ne vend te gjitha dokumentacionit e shoqerise qe e vlersojne te dobishme ne ushtrimin e detyres se tyre.

Kreu V Veprimtaria e shoqerise

NENI 12

Viti ekonomiko-financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti. Viti i pare financiar fillon ne daten e themelimit te shoqerise.



NENI 13

Shoqeria do te mbaje librin e llogarise ne leke dhe ne valute te huaj dhe do te beje perlllogaritjet e do te nxjerre bilancin ne perputhje me ligjin nr.7661, date 19.1.1993 " Per kontabilitetin".

NENI 14

Emerimi dhe marja ne pune, caktimi i pages per çdo punonjes dhe larghimin nga puna, jane kopetenca e administratorit.

Mardheniet e punes mes shoqerise si punedhense dhe punemarrese rregullohet me kontratat e punes dhe legjislacionin ne fuqi ne republiken e Shqiperise.

KREU VI

(Prishja), Shperndarja dhe likujdimi

NENI 15

Shoqeria mund te shperndahet per shkaqet e meposhtme:

a) me mbarimin e afatit te percaktuar ne nenin 3 te ketij statuti dhe ne rast ndryshimi te tij ne baze te dispozitave te ketij statuti me mbarimin e ketij afati te ri.

b) Me vendim te ortakeve.

c) Me humbjen e gjysmes se kapitalit themeltar, mbasi te jete shpenzuar dhe fondi rezerve ne baze te nenit 72 te ligjit nr.7638, date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare", ne rast se ortaket nuk merrin vendim per te plotesuar kapitalin ose zvogeluar ate ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne rastin e prishjes se shoqerise shoqeria do te likujdohet;

Ortaket duhet te caktojne nje ose disa likujdator. Likujdimi i shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e seksionit te vetem te kreut te 5 (peste) te ligjit nr.7638, date 19.11.1992, " Per shoqerite tregtare".

NENI 16

Te pakten 15 dite perpara mbledhjes se asamblese qe duhet te aprovoj llogarit sociale kete llogari do te jene ne dispozicion te ortakeve ne seline e shoqerise. Keshilli i administrimit do te percaktoje rregullat operative per ti bere te mundur ortakeve konsultimin e librave e llogarive sociale te pakten 2 here ne vite.

NENI 17

Cdo mosmarrveshje qe do te linde ndermjet ortakeve dhe administratoreve do ti ngarkohen apo jepen nje keshilli arbitrues i perbere nga 3 anetare nga te cilet 2 te emeruar nga gjykata e rrethit Tirane.Arbitrat do te gjykojne perfundimisht konfliktin e hapur shoqeris .

NENI 18

Shoqeria mund te vendose pjese te kapitalit te vet me shumice votash ne shoqeri te tjera.

NENI 19

Persa nuk eshte e parashikuar nga statuti i tanishem do te zbatohet legjislacioni ne fuqi.

NENI 20

Ne rast mosperputhjeje te tekstit ne italisht dhe te tekstit ne shqip do te jete i vlefshem vetem teksti ne italisht.

Sa u tha me lart vlen per tani dhe per te ardhmen.

SHOQERIA -"ELBA-SHEHU"-SH.P.K

XHEVDET SHEHU

YLLI SHEHU

EDMOND SHEHU

V E N D I M

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE

" ELBA-SHEHU " SH.P.K. - No 1

Sot me date 16.04-2002 Asambleja e ortakeve te shoqerise "ELBA-SHEHU " sh.p.k e perbere nga Z.Xhevdet Shehu , Ylli Shehu, Edmond Shehu :

K O N S T A T O I

Se shoqeria " ELBA-SHEHU " sh.p.k eshte rregjistruar me vendimin e gjykates se rrethit Tirane me nr 17104 date 04-05-1997.

Sipas ketij vendimi Shoqeria " ELBA-SHEHU " rezulton te kete ortake te saj Z. Xhevdet Shehu, Ylli Shehu, Edmond Shehu , administrator Z. Xhevdet Shehu, kapital fillestar te shoqerise 100.000 leke dhe objekt te aktivitetit te saj ne fushen e :

"Eksport-import te bimeve medicinale, te te gjitha llojeve te mallrave industriale , konfeksione, ushqimore, pjese kembimi, pajisje e makineri, shitje me shumice dhe me pakice ."

Ortaket e kesaj shoqerise moren ne shqyrtim rendin e dites me keto pika:

- Transferimin e kuotave te kapitalit themeltar -nga ortaku Edmond Shehu ne favor te Z. Xhevdet Shehu dhe Z. Ylli Shehu .

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992

V E N D O S I M

-Transferimin e kuotave te kapitalit themeltar nga ortaku Edmond Shehu ne favor te Z. Xhevdet Shehu dhe Z. Ylli Shehu .





-Te procedohet me kontraten e shitblerjes se kuotave te kapitalit themeltar .

ORTAKET E SHOQERISE " ELBA-SHEHU " SH.P.K

Xhevdet Shehu

Ylli Shehu

Edmond Shehu



V E N D I M

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE “ELBA-SHEHU” SH.P.K

Nr.2 date 01.09.2004

Sot me date 01.09.2004 Asambleja e Ortakeve te shoqerise “ELBA SHEHU” sh.p.k e perbere nga ortaku XHEVDET SHEHU dhe ortaku YLLI SHEHU, mbeshtetur ne ligjin nr.7638 date 19.11.1992 dhe ne Statutin e shoqerise ne nenin nr.5 dhe nr.6 te ketij Statuti.

V E N D O S I :

1.Te shtoje objektin e veprimtarise se shoqerise ne nenin nr.5 te statutit te shoqerise si vijon:


▲ **“Kultivimin e bimeve te rralla,bimeve mjekesore, aromatike, eterovajore dhe ushqimore”.**

2. Ky vendim i bashkengjitet Statutit te shoqerise “ELBA-SHEHU” sh.p.k.


3.Ky vendim te depozitohet ne rregjistrin tregtar ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane.

ORTAKET E SHOQERISE “ELBA-SHEHU” SH.P.K.

Xhevdet Shehu




Ylli Shehu



REPUBLIKA E SHQIPERISE
SHOQERIA "Elba Shehu "SH.P.K.
ELBASAN

Elbasan 20.1.2006



ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE "ELBA-SHEHU " SH.P.K.

Ne Elbasan, sot me date 20.1.2006 asambleja e ortakeve te shoqerise ""ELBA SHEHU
"SH.P.K. ,me pjesmarrjen e ortakeve ~~Xhevdet Shehu dhe Ylli Shehu~~

Vendosi

1. Te shese nje pjese te kuotave pjesmarrese te ortakeve Ylli Shehu dhe Xhevdet Shehu .
2. Te ~~pranoje~~ pranoje si ortak te ri z Edmond Shehu me pjesmarrje ne kuota ne masen 33.33 % .
- 3.Ortaket e Shoqerise jane Ylli Shehu, Xhevdet Shehu dhe Edmond Shehu ne masen 33.33 % te kuotave pjesmarrese sejcili
4. Te miratoje ndryshimet ne status dhe ne akt themelimi persa i perket ortakeve dhe kuotave pjesmarrese

Perfundimisht Ortaket vendosen per shtimin e ortakeve ne shoqeri .



Elbasan me 20.9.2006

V E N D I M

Nr 5

I

ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE "ELBA SHEHU" SH.P.K.


Ne Elbasan, sot me date 20.9.2006 asambleja e ortakeve te shoqerise "ELBA SHEHU" shpk . ,me pjesmarrjen e ortakeve Xhevet Shehu, Ylli Shehu dhe Edmond Shehu u mblodh ne nje mbledhje te zakonshme nga ku vendosi

1. Te shtoje objektin e veprimtarise se shoqerise, duke i shtuar atij edhe veprimtarine ne :

